

Ngritja e mëtejme dhe gjuha

Keni kaluar kohën e shkollimit dhe arsimimit jashtë Zvicrës dhe kërkonti punë në Zvicër? Ose dëshironi të ngriheni mëtutje në Zvicër?

„Parlez-vous français?“ „Sprechen Sie Deutsch?“ „Parla italiano?“

Pa marrë parasysh nëse kërkonti punë ose dëshironi të arsimoheni, një prej parakushteve më të rëndësishme për këto është njohja e një gjuhe lokale të vendit. Zvicra ka katër gjuhë zyrtare: gjermanishten, frëngjishten, italishten dhe gjuhën retoromanishten (Rumantsch grischun).

Nëse jetoni në pjesën gjermanofolëse, atëherë filloni me gjuhën letrare gjermane! Me këtë e keni një bazë të mirë që më vonë të kuptoni edhe gjermanishten zvicerane ose bile edhe ta flisni këtë dialekt.

Për punë ndihmëse mjafton nëse e kuptoni gjuhën përkatëse dhe mund të flisni nga pak. Mirëpo, edhe nga punëtorët ndihmës gjithnjë e më shumë pritet të dinë nga pak shkrim dhe lexim, ndërsa për punët më të vështira (komplekse) duhet të keni njohuri dukshëm më të mira të gjuhës. Për një ngritje të mëtejme ose për studime duhet të jeni në gjendje t'i lexoni dhe t'i kuptoni tekstat e komplikuar dhe vetë të shkruani tekste: varësisht nga qëllimi juaj, duhet të arrini një nivel të caktuar të njohurive të gjuhës. Për këtë arsye është me rëndësi të informoheni se cilat kurse të gjuhës janë të nevojshme për të arritur qëllimet tuaja.

Për çdo rast: gjuha nuk është e rëndësishme vetëm për punë ose ngritje të mëtejme në Zvicër. Edhe në situata të tjera jetësore, njohja e gjuhës është e dobishme: për shembull për të biseduar me fqinjë, gjatë blerjes, për të biseduar me mësimdhënës, mjekun, për mbushjen e formularëve, në kontakte me organet zyrtare dhe me institucionet shtetërore etj.

Një listë të kurseve të gjuhës e gjeni në internet.

Gjermanisht: www.berufsberatung.ch > Aus- und Weiterbildung > Fremdsprachen > Suche

Frëngjisht: www.orientation.ch > Formations > Apprendre une autre langue > Recherche

Italisht: www.orientamento.ch > Formazioni > Corsi e soggiorni linguistici > Ricerca

Informacionet e tjera mbi kurset e gjuhës i gjeni edhe te këshillimoret profesionale.